



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 15120 Prot

Shkodër, më 26.10.2020

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër" njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, ditën e **premtë, datë 30 Tetor 2020, ora 17:00**, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, me rend dite si më poshtë:

1. Dëgjesë me Kryetarin e Bashkisë dhe Administratorin e K.F.Vllaznia sh.a., mbi disa çështje të K.F.Vllaznia sh.a., referuar kërkesës së një grupi këshilltarësh.
2. Pr/ Vendim: " Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%), për muajin Shtator 2020 "
3. Pr/ Vendim: "Për miratimin e shitjes së mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik për skrap"
4. Pr/ Vendim: "Për miratimin për dhënie me qira/enfiteozë të pronës thertore tek ura e bunës me nr. Pasurie 19/63 me sipërfaqe 633m2 nga të cilat 492 m2 ndërtesë, me nr.pasurie 19/156 e llojit truall me sip 258 m2 e ndodhur në zonën kadastrale 8591-indeksi i hartës r-3, me nr.rendorë 107,në listën e inventarit të pronave, me qëllim me objekt zhvillimit të pronës me fushë përdorimi sipas VKB nr.9, datë 26.2.2020"
5. Pr/ Vendim: "Për ndryshimin e një pjese të segmentit rrugorë në oblikë nga rruga Krebaj, në rruga Admir Bokrina, sikurse përcaktohet në hartën treguese bashkëngjitur"
6. Pr/ Vendim: "Për ndryshimin e emërimit të sheshit Rus i Vogël në sheshi Dom Simon Jubani"

7. Pr/ Vendim: "Për ndryshimin e emërimit të sheshit Rus i Madh në sheshi Hafiz Sabri Koçi"
8. Pr/ Vendim: "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë qendrës komunitare për familjen nr.6 (Pranë ish konviktit të shkollës pyjore)
9. Pr/ Vendim: "Për miratimin e listës plotësuese së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti për vitin 2020"
10. Pr/ Vendim: "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të sipërfaqes 10m2 truall, subjektit Vodafone Albania sh.a., në stadiumin Loro Boriçi, ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip.28634 m2, pasuria nr.7/39, fletë inventari 221, në pronësi të Bashkisë Shkodër"
11. Pr/ Vendim: "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të sipërfaqes 10m2 truall, subjektit Albtelekom Albania sh.a., në stadiumin Loro Boriçi, ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip.28634 m2, pasuria nr.7/39, fletë inventari 221, në pronësi të Bashkisë Shkodër"
12. Pr/ Vendim "Për miratimin e planit të aktiviteteve të këshillit bashkiak shkodër për vitin 2021"
13. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni për çështje ligjore	E enjte	29.10.2020	10:00
2	Komisioni i shëndetësisë, veterinarisë dhe mbrojtjes së konsumatorit	E enjte	29.10.2020	11:00
3	Komisioni i financave, buxhetit dhe asetëve	E enjte	29.10.2020	12:00
4	Komisioni i vlerësimit të figurave dhe emërtesave	E enjte	29.10.2020	13:00
5	Komisioni i shërbimeve sociale, strehimit	E enjte	29.10.2020	14:00

Duke ju falenderuar,

KRYETARE

